REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KRYETARI

Nr. 6518 Prot.

Tiranë, më 16.11.2026

U R DH Ë R

Nr. 68, datë 16.11.2026

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE NË DATËN 18.11.2026, ORA 10:00

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, nenit 27/1 dhe neneve 79 dhe 82 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e veçantë për shqyrtimin e projektligjit "Për buxhetin e vitit 2027" dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të,

U R D H Ë R O J:

I. Mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 18.11.2026, ora 10:00.

II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 29.10.2026.
2. Njoftime.
3. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar". *(Shqyrtimi në parim)*
4. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". *(Shqyrtimi në parim)*
5. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". *(Shqyrtimi në parim)*
6. Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar". *(Shqyrtimi në parim)*
7. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". *(Shqyrtimi në parim)*
8. Projektligji "Për buxhetin e vitit 2027". *(Shqyrtimi në parim)*
9. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar".
10. Projektvendim "Për një ndryshim në vendimin Nr.169/2026 të Kuvendit "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për fazën e dytë të Reformës Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë"
11. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.

IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Niko PELESHI

Legjislatura XI
Sesioni III

SEANCË PLENARE PUBLIKE

E mërkurë, 18 nëntor 2026, ora 10:00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrit nr. 68, datë 16.11.2026 të Kryetarit të Kuvendit, z. Niko Peleshi, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 29.10.2026.
   (Neni 44, pika 2, të Rregullores së Kuvendit)

2. Njoftime.
   (Neni 44, pika 3, të Rregullores së Kuvendit)

3. **Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar".** *(Shqyrtimi në parim)*
4. **Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".** *(Shqyrtimi në parim)*
5. **Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".** *(Shqyrtimi në parim)*
6. **Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar".** *(Shqyrtimi në parim)*
7. **Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".** *(Shqyrtimi në parim)*
8. **Projektligji "Për buxhetin e vitit 2027".** *(Shqyrtimi në parim)*
   (Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 dhe 158, të Kushtetutës, të nenit 30, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe neneve 55, 73-74, 78-82 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratimin në parim të projektligjit të buxhetit dhe të projektligjeve financiare)
   Pyetje
   Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë, Punësimin dhe Financat
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare)
Koha e votimit në parim

9. **Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar".** *(Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55, 73 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*
   Pyetje
   Shprehet nismëtari
   Shprehet Komisioni përgjegjës për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm
   Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike
   Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat
   Diskutime
   (Shprehen grupet parlamentare)
   Koha e votimit

10. **Projektvendim "Për një ndryshim në vendimin nr. 169/2026 të Kuvendit "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për fazën e dytë të Reformës Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë"".** *(Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*
    Koha e votimit

11. **Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.** *(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)*